



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.325/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore: Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës në afërsi të qendrës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të datës 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.325/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës në afërsi të qendrës së votimit i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro, , dhedetyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbartimit**.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06 Tetor 2019, në ditën e zgjedhjeve një veturë me material propagandues elektoral të PDK-së, është parë në afërsi të vend votimit “2101X” në shkollën “Hamëz Jashari” në Skenderaj, kjo vërtetohet me anë të fotografisë të cilën e kemi bashkangjitur në ankesë. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 3 pika 4 e rregullës zgjedhore nr.13/2013 “Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2019 subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) konsideron se ankesa e BIRN dhe IKS është e pabazuar, për faktin se sipas fotos nga ankuesi nuk shihet qart se pranë veturës së ndalur është shkolla, dhe nuk ka fakte se aty është një objekt apo ndërtesë publike.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e provës, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat vërtetoi faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se vetura me material propagandues elektoral të subjektit politik PDK, është ndalur në afërsi të vendvotimit “në ditën e votimit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin nenin 36 par.1, pika dhe b), të LZP-së, e cila përcakton se: “ Njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”, ky fakt është vërtetuar nga fotografia e cila gjendet ne shkresat e lëndës, andaj e **pranoj si të bazuar ankesën** dhe vendosi si në dispozitiv duke marr parasysh arsyet në vijim për shqiptimin e lartësisë së gjobës.

Se vetura me material propagandistik është në afërsi të vendvotimit, dhe se objekti afër veturës është vendvotim, kjo vërtetohet në bazë të fotografisë ku aty shihen njerëzit duke pritur në rradhë për të votuar.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 325/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.